



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2251267

Tiranë, më 06/08/2018

NJOFTIM
PËR KONTRAKTIM TË EKSPERTËVE TË JASHTËM NË AUDITIMET NË
PROCES TË DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS NË
KLSH

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi auditimin e performancës, ISSAI 100, paragrafët 39, 45 dhe 48; ISSAI 300, paragrafët 30 dhe 37, në Ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenet 40 dhe 41, Kontrolli i Lartë i Shtetit kërkon të kontraktojë ekspertizë të jashtme për auditimet e performancës në proces, dhe konkretisht:

1. Rritja e kapaciteteve njerëzore në administratën publike shqiptare;
2. Cilësia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë Institucioneve publike të Arsimit të Lartë;
3. Menaxhimi i plazheve publike;
4. Performanca e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare;
5. Menaxhimi i klubeve shumësportësh;
6. Parqet rekreative në qytetin e Tiranës;
7. Përmbytjet: parandalimi dhe mbrojtja;
8. Siguria rrugore-sinjalistika dhe mirëmbajtja e rrugëve.

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes depozitimit elektronik të dosjes në adresën e drejtorit të auditimit të performancës në KLSH, rmuca@klsh.org.al, deri më dt. 29.08.2018.

Dosja personale duhet të përmbajë:

1. CV;
2. Ide, në formë eseje, për trajtimin e problematikave në një nga fushat e mësipërme të marra nën auditim.

Aplikantët do të informohen nëse janë përzgjedhur ose jo për fazën e intervistës, e cila do të realizohet në datat 30.08.2018-02.09.2018.

Kandidatët që kanë aplikuar më parë duhet të përcjellin idenë e tyre në formë eseje për problemet aktuale të fushës së ekspertizës, në adresën rmuca@klsh.org.al.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE